



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL, ARSIMIT, RINISË DHE
SPORTEVE
DREJTORIA E MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE

Nr. 4027 Prot.

Elbasan, më 27 08/2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Lënda: Relacion për Planin Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të parimeve të qeverisjes vendore, në përputhje me prioritetet e politikave sociale kombëtare dhe në funksion të nevojës për përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave të mbrojtjes sociale në nivel vendor, Bashkia Elbasan ka ndërmarrë një proces rishikimi të Planit Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2024-2027.

Arsyet e rishikimit:

1. Ndryshimet sociale dhe demografike

Në vijim të analizave të kryera nga strukturat e Bashkisë dhe institucioneve partnere:

- Është vërejtur një ndryshim në përbërjen demografike të popullsisë, përfshirë rritjen e përqindjes së grupmoshave të moshuara, si dhe zhvendosjen e popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane.
- Janë konstatuar rritje të rasteve të vulnerabilitetit social, të lidhura me faktorë ekonomikë, papunësinë, ndryshimet në strukturën familjare, emigracionin etj.
- Është e nevojshme të përditësohen prioritetet dhe masat ndërhyrëse, për të qenë në përputhje me realitetin e ri shoqëror dhe për të ofruar shërbime më efektive dhe gjithëpërfshirëse.

2. Shtesë specifike për pakicat rome dhe egjiptiane

Nisur nga fakti që Plani Vendor i Veprimit të Mbrojtjes Sociale aktual 2024-2027 nuk kishte të përfshirë masa që mundësojnë integrimin e pakicave rome e egjiptiane si pasojë e ekzistencës së Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019–2022 (miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 43, më 30 prill 2020), u pa e nevojshme përfshirja e masave për integrimin e këtyre pakicave në Planin Vendor të Veprimit të

Mbrojtjes Sociale 2025-2028. Duke marrë parasysh edhe rekomandimet e dala nga proceset e konsultimit publik dhe nga raportet takimeve me Grupin e Punës, aktorë të tjerë si edhe me përfaqësues të organizatave që punojnë me pakicat rome dhe egjiptiane:

- Është identifikuar nevoja për një përfshirje më të gjerë dhe të thelluar të këtyre komuniteteve në politikat dhe programet sociale të Bashkisë.
- Plani i rishikuar parashikon një shtojcë të dedikuar për pakicat rome dhe egjiptiane, ku përfshihen masa të posaçme për përmirësimin e aksesit në shërbime sociale, regjistrim civil, kujdes shëndetësor, strehim social, arsim dhe punësim;

Përmbajtja e rishikimit

Plani i rishikuar ruan strukturën bazë të dokumentit fillestar, por përfshin:

- Përditësimin e të dhënave statistikore;
- Rishikimin e objektivave strategjike dhe veprimeve prioritare;
- Shtojcën për pakicat rome dhe egjiptiane;
- Masa të reja për përfshirjen e të rinjve, grave në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, dhe të moshuarve.

Përfundim

Ky rishikim synon të rrisë efektivitetin, gjithëpërfshirjen dhe qëndrueshmërinë e politikave të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Plani është hartuar në bashkëpunim me aktorë lokalë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetet në nevojë, duke reflektuar një qasje sa më afër realitetit dhe nevojave të qytetarëve.

Kërkojmë miratimin nga Këshilli Bashkiak për këtë rishikim të Planit Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028, në mënyrë që të vijojë më tej zbatimimi i tij në përputhje me objektivat zhvillimore të Bashkisë dhe parimet e barazisë sociale.

Duke ju falenderuar !

KRYETAR

Gledian Llatja

ME URDHËR E POROSI

Zv/KRYETAR

Armand Shehu

